



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Lënda: Njoftim për zhvillimin e procedurës administrative ndaj z. Arben QALLIU, për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data
07.01.2021

Nr. Protokolli

84

Drejtuar: **Z. ARBEN QALLIU**

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

DREJTOR – DREJTORIA VENDORE ASHK LUSHNJË

Sheshi i Qytetarëve, Pranë Bashkia Lushnje, Lushnjë

Për dijeni: **AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS -**

Rr. Dora D'Istria, Nr. 21001, Tiranë

Ju bëjmë me dije se, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë raportuar dy denocime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, për veprimtaritë e deputetit të PS, Qarku Fier, z. Bujar Çela, i cili ka publikuar në llogarinë e tij personale në Facebook disa foto me qytetarë të ndryshëm duke shpërndarë leje legalizimi të shtëpive të tyre në Njësinë Administrative Hyzgjokaj.

Bazuar në denoncimet e raportuara, ju bëjmë me dije se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ditën e hënë, më datë 11.01.2021, ora 12:00, zhvillon seancën dëgjimore për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me z. Arben Qalliu, Drejtor i Drejtorisë Vendore të A.SH.K Lushnjë.

Bazuar në nenin 47 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e hënë, më datë 11.01.2021, në adresë Rr.Ibrahim Rugova, nr.4, Tiranë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

